**KONTRATE SHIT-BLERJE**
**Kuotave te shoqërisë "BAZAMO 2020",**
**Baza Ligjore**
**Nenet 6, 705-750 te Kodit Civil**

Në Tiranë, sot më 01/04/2021 (dymijë e njezete e nje), palet:

**SHITESI: Z. Nikolle Ndoci**, i datëlindjes 01.08.1967, lindur në Gjadër, Lezhë dhe banues në Tiranë shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik me nr. personal **G70801069S**

**BLERESIT:**

- **Zoti Zaid El Abed,** shtetas Palestinez , lindur ne Palestine, me 01.01.1980, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes Libaneze me nr.534516 :
- **Zoti Mohamad Chaaban,** shtetas Palestinez, lindur ne Ajman Palestine, me 26.11.1981, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e pasaportës Libaneze me nr. PR0131292.
- **Zoti Basheer H.S.Bakroun,**shtetas Palestinez,lindur ne Gaza Palestine, me 16.10.1975, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar,mbajtes i pasaportes me nr.3917083

Palët, me vullnetin e tyre te lire, te plote dhe ne mirëkuptim te ndërsjelle, nenshkruajn kete kontrate, ne kushtet dhe me te dhënat e mëposhtme:

**TE DHENA PARAPRAKE**

I. Shitësi është ortak i 25% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqërisë Kufizuar BAZAMO 2020" me NIPT M01328505D, themeluar dhe regjistruar me date 27/01/2020, me seli ne adresën: Durres, Rrashbull, banesa me nr. pasurie 94/175, Zona kadastrale nr. 3215 kati 2.

II. Shoqëria "BAZAMO 2020" me vendimin nr. 2, date 10.04.2021 te Asamblesë se Përgjithshme te Ortakeve kane dhëne pëlqimin për shitjen 25 % te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë "BAZAMO 2020", nga totali i kuotave prej 25% te ortakut Z. **Nikolle Ndoci,** ne cilësinë e shitësit, tek blerësit, perkatesisht ortaket e shoqerise, Zoti **ZAID EL ABED- 5 %** ortakut, **Z. MOHAMAD CHAABAN- 10%** si dhe ortakut, **Z. BASHEER H.S.BAKROUN 10%**

III. Mbi kuotat e kapitalit themeltar te shoqërisë "BAZAMO 2020", nuk ka asnjë barre siguruese.

**NENI 1**
**Objekti**

Objekti i kësaj kontrate është shitja e pasurisë se luajtshme sipas kuotave te përcaktuara me poshtë, te kapitalit themeltar te shoqërisë "BAZAMO 2020", nga shitësi ne favor te palëve blerëse.

- **Z. Nikolle Ndoci,** shet 25% nga pjesa e vet prej 25% te kuotave me vlere nominale 25 000 (njezetee pese mije) lek.

**NENI 2**
**Çmimi**

2.1 Shitësi ia shet këtë pasuri blerësve kundrejt një çmimi dhe përkatësisht sipas ndarjes:

**a) Z. Nikolle Ndoci,** shet 5% nga pjesa e vet takuese prej 25% te kuotave te shoqërisë "BAZAMO 2020", me vlere nominale 5 000 (pese mije) lek, te cilat i blen Z. **ZAID EL ABED.**

*Te dhenat personale mbrohen*

b) **Z. Nikolle Ndoci,** shet 10% nga pjesa e vet takuese prej 25% te kuotave te shoqërisë "BAZAMO 2020", me vlere nominale 10 000 (dhjete mije) lek, te cilat i blen Z. **MOHAMAD CHAABAN.**

c) **Z.Nikolle Ndoci,**shet 10% nga pjesa e vet takuese prej 25% te kuotave te shoqerise "BAZAMO 2020", me vlere nominale 10 000 (dhjete mije) lek, te cilat i blen **Z.Basheer H.S.Bakroun**

2.2. Palët deklarojnë se çmimi është paguar nga blerësi ne favor te shitësit, te cilët nuk kane asnjë pretendim.

2.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate shitje kuotash dhe regjistrimin e saj ne QKB, Z. **Nikolle Ndoci largohet** si ortak i Shoqërisë "BAZAMO 2020", ndërsa zoti Z **ZAID EL ABED behet** ortak i shoqërisë me 30% te kuotave te shoqërisë "BAZAMO 2020", me një vlere nominale prej 30 000 (tridhjete mije) lek; Z. **MOHAMAD CHAABAN behet** ortak i shoqërisë me 35% te kuotave te shoqërisë "BAZAMO 2020", me një vlere nominale prej 35 000 (tridhjete e pese mije) lek, si dhe **Z.BASHEER H.S.BAKROUN behet** ortak i shoqerise me 35% te kuotave te shoqërisë "BAZAMO 2020", me një vlere nominale prej 35 000 (tridhjete e pese mije) lek

**NENI 3**

**Te drejtat dhe detyrimi i palëve**

3.1 Shitësi garanton blerësin për titullin e pronësisë te pasurisë objekt kontrate dhe saktësinë e dokumentacionit zyrtar te saj, ne te kundërt mban përgjegjësi civile për demin e shkaktuar.

3.2 Shitësi është i detyruar ti dorëzoje pasurinë objekt kontrate me gjithë dokumentacionin përkatës blerësit, me marrjen e pagesës nga ky i fundit.

3.3 Shitësi është i detyruar ti dorëzoje pasurinë objekt kontrate blerësit te shkarkuar nga çdo e drejte apo pretendim i te tretëve.

3.4 Blerësi ka detyrim te njoftoje brenda 5 ditëve shitësin ne rast se te trete ngrëne pretendime pronësie mbi sendin objekt kontrate.

**NENI 4**

**Kalimi i pronësisë**

Me nënshkrimin e kontratës, shitësi **Nikolle Ndoci zhvishet** plotësisht nga pronësia mbi 25% (njezete e pese për qind) te kuotave si me sipër dhe ajo i kalon e plote blerësve. Blerësit:

- Zoti **ZAID EL ABED, behet** zotërues i 5% (pese për qind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë "BAZAMO 2020"" te perfituara nga shitesi Nikolle Ndoci, duke u bere keshtu ortak me 30% te kuotave te shoqerise,
- Zoti **MOHAMAD CHAABAN, behet** zotërues i 10% (dhjete për qind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë "BAZAMO 2020" te perfituara nga shitesi Nikolle Ndoci, duke u bere keshtu ortak me 35% te kuotave te shoqerise.
- Zoti **BASHEER H.S.BAKROUN,behet** zotrues i 10% (dhjete për qind) te kuotave te kapitalit themeltar te shoqërisë "BAZAMO 2020" te perfituara nga shitesi Nikolle Ndoci, duke u bere keshtu ortak me 35% te kuotave te shoqerise.

**NENI 4**

**Te ndryshme**

5.1 Palët u porositen qe te depozitojnë këtë kontrate ne Qendrën Kombëtarë te Biznesit.

5.2 Palët do te përpiqen te zgjidhin me mirëkuptim te gjitha mosmarrëveshjet qe mund te lindin për shkak te ekzekutimit te kësaj kontrate. Ne rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre ehte Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Kontrata iu lexohet të paleve te cilët e kuptojnë, pranojnë përmbajtjen e aktit dhe e nënshkruajnë atë pa vërejtje, duke vënë emrin e mbiemrin.

Kontrata redaktohet ne 4 kopje origjinale, me përmbajtje dhe vlere te njëjtë juridike.

**SHITESI**

**Nikolle Ndoci**

**BLERESI**

**Zaid El Abed**
**Mohamad Chaaban**
**Basheer H.S.Bakroun**

BAZAMO 2020 Sh.p.k. NUIS M 01326505 D DURRES - ALBANIA